

Përmbledhje

Pasojat nga përballja me pandeminë COVID-19 u reflektuan në rënie të aktivitetit ekonomik në Eurozonë në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2020. Gjatë TM3 2020, me hapjen e ekonomisë dhe lehtësimit të masave, ekonomia e Eurozonës filloi rikuperimin ku rritja tremujore ekonomike e shënuar ishte 12.7 përqind, përderisa krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 aktiviteti vlerësohet të ketë rënë për 4.3 përqind. Kriza ekonomike dhe sociale është reflektuar edhe në dinamikat e çmimeve në eurozonë, me ç'rast shkalla e shënuar e inflacionit ishte 0.0 përqind. Me krizë ekonomike është duke u ballafaquar edhe rajoni i Ballkanit Perëndimorë, ku vetëm në TM2 2020 është vlerësuar rënie ekonomike prej 11.8 përqind, përderisa parashikimet e fundit të FMN-së sugjerojnë rënie të aktivitetit ekonomik prej 6.9 përqind në vitin 2020.

Bazuar në vlerësimet e ASK-së, BPV-ja reale në gjysmën e parë të vitit 2020 shënoi rënie prej 4.6 përqind. Me rënie janë karakterizuar investimet dhe eksportet neto, ndërsa konsumi vlerësohet të ketë shënuar rritje. Megjithë hapjen e ekonomisë në tremujorin e tretë të vitit 2020, trendi i rënies së aktivitetit ekonomik vlerësohet të ketë vazhduar. Këto vlerësime mbështeten në rënien eksportit të shërbimeve, rënien e shpenzimeve kapitale të qeverisë, rënien e IHD-ve, etj.

Çmimet e konsumit shënuan rënie prej 0.4 përqind në TM3 2020, kryesisht si pasojë e rënies së çmimeve të transportit, rekreacionit, orendive, veshmbathjes, energjisë, etj. Rritje të ngadalësuar të çmimeve kanë shënuar edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, duke bërë që deflacioni bazë të jetë 0.9 përqind.

Spektori fiskal gjatë TM3 2020 u karakterizua me rënie të të hyrave buxhetore prej 13.5 përqind dhe rritje të shpenzimeve buxhetore prej 11.1 përqind. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 86.4 milionë euro. Borxhi publik ka arritur në 1.3 miliardë euro, që është për 12.2 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 19.9 përqind, nga 17.4 përqind sa ishte në TM3 2019.

Asetet e sistemit financiar u rritën për 258.8 milionë euro në TM3 2020, kryesisht si rezultat i rritjes së aseteve të sektorit bankar dhe sektorit pensional. Rritja e aseteve të sektorit bankar i atribuohet kryesisht depozitave të arkëtuara në këtë tremujor, që njëherësh paraqet dhe burimin kryesor të financimit të aktivitetit bankar. Kurse, zgjerimi i aseteve të sektorit pensional erdhi si rrjedhojë e kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet. Spektori i sigurimeve u karakterizua me rritje më të ngadalëshme të aktivitetit. Niveli i primeve shënoi rritje të lehtë, përderisa vlera e dëmeve të paguara dhe atyre të ndodhura ishte dukshëm më e lartë. Në të njëjtën periudhë, sektori mikrofinanciar shënoi ngadalësim të theksuar të rritjes së aktivitetit, si dhe performancë financiare më të ulët se në periudhën paraprake.

Gjatë TM3 2020, sektori i jashtëm është karakterizuar me deficit të llogarisë rrjedhëse prej 90.9 milionë euro, që i atribuohet zvogëlimit të theksuar të bilancit pozitiv të shërbimeve. Në anën tjetër, deficit i mallrave ishte më i ulët si dhe bilancet pozitive të të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore ishin më të larta. Në kuadër të bilancit të pagesave, gjatë TM3 2020, remitencat shënuan rritje prej 18.1 përqind përderisa IHD-të shënuan rënie prej 27.0 përqind.

PËRMBAJTJA

Përmbledhje -----	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	4
Ekonomia e Kosovës -----	6
Sektori Real -----	6
Çmimet -----	6
Sektori Fiskal -----	7
Sektori Financiar -----	8
Sektori i Jashtëm -----	9

FIGURAT DHE TABELAT


Figura 1. Norma e rritjes së BPV-së dhe inflacionit në Eurozonë-----	04
Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë-----	06
Figura 4. Deficiti i llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj-----	09
Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave-----	10
Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	10
Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive-----	10
Figura 8. Remitencat-----	11
Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte-----	12
Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në Ballkanin Perëndimor-----	05
Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit në Ballkanin Perëndimor-----	05
Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej inflacionin-----	07
Tabela 4. Treguesit e zgjedhur makroekonomik-----	14

SHKURTESAT:

ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet e Huaja Direkte
IÇIMP	Indeksi i Çmimit të Importit
MF	Ministria e Financave dhe Transfereve e Republikës së Kosovës
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Si rezultat i hapjes së ekonomisë së Eurozonës, aktiviteti ekonomik ka filluar të përmirësohet në TM3 2020. Krahasuar me tremujorin paraprak është shënuar rritje e BPV-së prej 12.7 përqind, që paraqet rritjen më të lartë të shënuar viteve të fundit. Ndërsa, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2019, sipas vlerësimeve preliminare të Eurostat-it, aktiviteti ekonomik në Eurozonë ka shënuar rënie prej 4.3 përqind (figura 1).



Burimi: Eurostat (2020)

Në mesin e vendeve kryesore të Eurozonës, Gjermania dhe Franca shënuan rënie të aktivitetit ekonomik prej 4.2 përqind përkatësisht 4.3 përqind, ndërsa Spanja ka raportuar një rënie të BPV-së prej 8.7 përqind. Sipas sektorëve, humbjet më të mëdha rezultojnë të jenë shënuar tek prodhuesit e automjeteve, transporti, si dhe aktivitetet e artit, argëtimit dhe rekreacionit. Për vitin 2020, kryesisht si pasojë e krizës shëndetësore, ekonomike dhe sociale që ka shkaktuar pandemia,

Banka Qendrore Evropiane (BQE) ka parashikuar rënie ekonomike prej 8.0 përqind.

Rënia e aktivitetit ekonomik u përkthye në dinamika të dobëta edhe në nivelin e çmimeve në eurozonë, kryesisht si pasojë e rënies së çmimeve të energjisë dhe rënies së çmimeve të prodhimeve industriale. Shkalla mesatare e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në TM3 2020 ishte 0.0 përqind (0.9 përqind në TM3 2019) (figura 1).

Me qëllim të zbutjes së efekteve të pandemisë dhe asistimit në rikuperim ekonomik përmes mbështetjes së financimit të ekonomisë reale (veçanërisht bizneseve dhe ekonomive familjare), në qershor 2020, BQE morri vendim lidhur me programin e ri të lehtësimit sasior. Ky program, i emërtuar si “Programi për Blerje Emergjente të Aseteve në Pandemi” u rrit në 1.35 miliardë euro, dhe pritet të zgjatë së paku deri në fund të qershorit 2021.

Në anën tjetër, aktiviteti kreditues dhe depozitues në Eurozonë ka vazhduar të rritet, rritje që është evidentuar si tek ndërmarrjet ashtu edhe tek ekonomitë familjare. Kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 6.5 përqind, ndërsa kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.5 përqind. Me rritje të lartë janë karakterizuar edhe depozitat në sistemin bankar, ku depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 19.5 përqind ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 6.7 përqind.

Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor u karakterizua me rënie mesatare prej 11.8 përqind në TM2 2020¹ (4.3 përqind rritje në TM2 2019). Shtetet bregdetare (Mali i Zi dhe Shqipëria), të cilat kanë një

¹ Të dhënat për TM3 2020 nuk janë publikuar ende.

varësi të lartë nga turizmi kanë shënuar rënie më të lartë të aktivitetit ekonomik, ndërsa Serbia rezulton të jetë ndikuar më pak nga kriza (tabela 1).

Tabela 1. Norma e rritjes së BPV-së reale në B. Perëndimor

Përshkrimi	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2
Serbia	2.6	2.9	4.8	6.2	5.1	-6.4
Mali i Zi	3.0	3.2	4.7	3.1	2.7	-20.2
Kosova	4.2	4.1	4.4	3.9	1.3	-9.3
Maqedonia e Veriut	3.8	3.4	3.6	3.4	0.2	-12.7
Shqipëria	2.4	2.6	4.2	-0.1	-2.5	-10.2

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Përveç problemeve të shkaktuara nga COVID-19, edhe pasiguritë e rritura politike në rajon pritet të pasqyrohen në rënie të mëtejme të besueshmërisë së investitorëve dhe konsumatorëve, duke ndikuar kështu drejtpërdrejtë në aktivitetin ekonomik. Për pasojë, parashikimet e realizuara nga FMN në tetor 2020 ishin më pesimiste krahasuar me parashikimet e realizuara në prill 2020, duke sugjeruar rënie të aktivitetit ekonomik në rajon për mesatarisht 6.9 përqind në vitin 2020.

Norma mesatare e inflacionit në TM3 2020 ishte 0.9 përqind, që është normë më e ulët krahasuar me 1.1 përqind sa ishte në TM3 2019. Në Kosovë dhe Mal të Zi është shënuar deflacion, ndërsa në vendet tjera të rajonit norma e inflacionit ishte më e lartë (tabela 2). Ky trend i inflacionit pritet të vazhdoj edhe në tremujorët në vazhdim dhe sipas FMN-së, norma mesatare e inflacionit në vitin 2020 pritet të jetë 0.9 përqind.

Tabela 2. Shkalla vjetore e inflacionit në B. Perëndimor

Përshkrimi	2019 TM1	2019 TM2	2019 TM3	2019 TM4	2020 TM1	2020 TM2	2020 TM3
Kosova	3.2	3.3	2.6	1.7	1.1	0.2	-0.4
Mali i Zi	0.4	0.5	-0.1	1.1	0.5	-1.1	-1.4
Maqedonia e Veriut	1.9	1.4	0.1	-0.5	-0.1	0.3	2.0
Serbia	2.4	2.3	1.3	1.4	1.7	1.0	1.9
Shqipëria	2.0	1.6	1.5	1.6	1.9	2.4	2.2

Burimi: Zyrat kombëtare statistikore të vendeve përkatëse

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, vendet e Ballkanit Perëndimorë shënuan rritje të aktivitetit kreditues prej 8.5 përqind, që është normë më e lartë e rritjes krahasuar me normën prej 6.5 përqind në TM3 2019. Vendet të cilat shënuan normat më të larta të rritjes ishin Serbia dhe Maqedonia e Veriut (14.0 përqind përkatësisht 10.0 përqind), pasuar nga Kosova (7.6 përqind), Mali i Zi (5.7 përqind) dhe Shqipëria (5.1 përqind). Depozitat shënuan rritje mesatare prej 6.6 përqind, që është normë më e ulët krahasuar me rritjen prej 8.7 përqind në TM3 2019. Norma më e lartë e rritjes është shënuar në Serbi dhe Kosovë (17.1 përqind përkatësisht 8.6 përqind), pasuar nga Maqedonia e Veriut (6.8 përqind) dhe Shqipëria (6.5 përqind), ndërsa në Mali i Zi është shënuar rënie (-6.1 përqind).


Gjatë TM3 2020, euro është zhvlerësuar ndaj frankës zvicerane (1.8 përqind), ndërsa është vlerësuar ndaj valutave tjera: 34.3 përqind ndaj lirës turke, 5.2 përqind ndaj dollarit amerikan, 1.9 përqind ndaj lekut shqiptar, 1.8 përqind ndaj kunës kroate, 0.3 përqind ndaj sterlinës britanike, etj.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real

Përballja me pandeminë COVID-19 dhe ndërmarrja e masave për menaxhimin e krizës shëndetësore ndikuan që aktiviteti ekonomik të ngadalësohet në TM1 (1.3 përqind) përkatësisht të shënoj rënie në TM2 2020 (-9.3 përqind). Në gjashtëmujorin e parë të vitit, ekonomia e vendit u karakterizua me rënie mesatare të BPV-së prej 4.6 përqind. Në këtë nivel të rënies së aktivitetit ekonomik kanë kontribuar investimet dhe eksportet neto me -8.7 përqindësisht -0.2 pikë përqindje. Në anën tjetër, aktiviteti ekonomik u mbështet nga kontributi pozitiv i konsumit me 4.2 pikë përqindje (figura 2).

Figura 2. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Burimi: ASK (2020) dhe llogaritjet e BQK -së

Në baza sektoriale, në gjysmën e parë të vitit 2020, rënien më të lartë e shënuan sektori i hoteleve dhe restoranteve (-39.0 përqind), ndërtimtarisë (-35.5 përqind), transportit dhe magazinimit (-33.1 përqind), aktiviteteve administrative dhe mbështetëse (-22.8 përqind), tregtisë (-5.0 përqind), etj. Në anën tjetër, rritja më e lartë është shënuar tek sektori i industrisë përpunuese (15.7 përqind), informimit dhe


komunikimit (15.7 përqind), furnizimit me energji elektrike dhe gaz (12.8 përqind), shëndetësisë dhe punës sociale (11.1 përqind), industrisë nxjerrëse (5.8 përqind), etj.

Përkundër hapjes së ekonomisë, vlerësohet se trendi i rënies së aktivitetit ekonomik ka vazhduar edhe në TM3 2020. Këto vlerësime mbështeten në rënien eksportit të shërbimeve në periudhën raportuese, rënien e shpenzimeve kapitale të qeverisë, rënien e IHD-ve, etj. Indikacion i rënies së kërkesës së brendshme është edhe rënia e importit të mallrave prej 9.3 përqind në TM3 2020. Në anën tjetër, remitencat kanë shënuar rritje edhe gjatë TM3 2020.

Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit shënoi rritje të ngadalësuar prej 0.3 përqind deri në shtator 2020, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019 kur ishte shënuar rritje prej 3.0 përqind. Duke filluar nga muaji korrik është shënuar rënie e çmimeve dhe mesatarja e deflacionit në TM3 2020 ishte 0.4 përqind (figura 3).

Figura 3. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2020)

Rënie e çmimeve në TM3 2020 është shënuar tek çmimet e transportit, çmimet e rekreacionit, çmimet e

orendive, veshmbathjes si dhe çmimet e energjisë. Në anën tjetër, rritje kanë shënuar çmimet e shërbimeve shëndetësore, hotelerisë, mjeteve të komunikimit, etj. Me rritje të ngadalësuar të çmimeve janë karakterizuar edhe çmimet e ushqimit dhe pijeve joalkoolike, mirëpo, për shkak të peshës së madhe në shportën e konsumatorit kosovarë, kontribuuan pozitivisht me 0.47 pikë përqindje në nivelin e përgjithshëm të çmimeve (tabela 3).

Tabela 3. Kontributi i kategorive specifike në gjithsej deflacionin gjatë TM3 2020

Përshkrimi	Peshat 2020	Norma e deflacionit	Kontributi
<i>GJITHSEJ</i>	100.0%	-0.4	-0.36
Ushqimi dhe pijet joalkoolike	40.1%	1.1	0.47
Pijet alkoolike dhe duhani	5.7%	0.6	0.04
Veshmbathja	4.1%	-0.2	-0.01
Energjia	7.7%	-0.1	0.00
Orenditë	7.6%	-0.4	-0.03
Shëndetësia	2.1%	4.9	0.10
Transporti	15.7%	-7.2	-1.15
Komunikimi	3.8%	0.5	0.02
Rekreacioni	4.4%	-1.2	-0.05
Arsimi	1.0%	0.5	0.00
Hoteleria	3.2%	2.3	0.07
Mallrat dhe shërbimet tjera	4.5%	4.2	0.17

Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së

Siç shihet në tabelë, shporta e konsumatorit kosovar karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqim, energji, pije alkoolike dhe duhan), dhe përjashtimi i këtyre komponentëve rezultoi në deflacion bazë edhe më të ulët se sa deflacioni i përgjithshëm (figura 3). Deflacioni bazë rezultoi të jetë 0.9 përqind, apo 0.5 pikë përqindje më i ulët se sa deflacioni i përgjithshëm.

Për shkak të varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamikat e shportës së konsumatorit kosovarë përcaktohen kryesisht nga lëvizja e çmimeve

të importit, të cilat në TM2 2020 shënuan rënie mesatare prej 3.5 përqind (3.9 përqind rritje në TM2 2019). Përveç çmimeve të importit, me rënie prej 1.5 përqind janë karakterizuar edhe çmimet e prodhimit por që kjo normë e rënies ishte më e ulët krahasuar me çmimet e importit.

Sektori Fiskal

Të hyrat buxhetore² deri në shtator 2020 arritën vlerën neto prej 1.2 miliardë euro (rënie vjetore prej 11.9 përqind), ndërsa shpenzimet buxhetore³ arritën vlerën prej 1.4 miliardë euro (rritje vjetore prej 5.4 përqind). Vetëm në TM3 2020, të hyrat buxhetore ishin 454.9 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 13.5 përqind, ndërsa shpenzimet buxhetore shënuan rritje prej 11.1 përqind dhe arritën vlerën prej 541.3 milionë euro. Rrjedhimisht, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 86.4 milionë euro gjatë këtij tremujori.

Pandemia COVID-19 ka ndikuar në rënien e kërkesës vendore, duke ndikuar në rënien e të hyrave tatimore direkte për 6.3 përqind në TM3 2020. Të gjitha kategoritë e të hyrave tatimore direkte shënuan rënie. Tatimi në të ardhurat e korporatave dhe tatimi në të ardhurat personale, si dy kategoritë kryesore të të hyrave tatimore direkte, shënuan rënie prej 2.5 përqind përkatësisht 3.7 përqind. Pandemia COVID-19 ka ndikuar negativisht edhe importin e mallrave, duke shkaktuar rënie prej 17.3 përqind në të hyrat tatimore indirekte të cilat arritën vlerën prej 335.5 milionë euro dhe përbëjnë 73.8 përqind të gjithsej të hyrave buxhetore në TM3 2020. TVSH-ja dhe akciza, si dy

² Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi dhe pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve.

³ Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

kategoritë kryesore të të hyrave tatimore indirekte, shënuan rënie prej 14.9 përqind përkatësisht 19.2 përqind.

Shpenzimet buxhetore u karakterizuan me rritje si rezultat i masave të ndërmarra për të zbutur efektet negative të pandemisë COVID-19. Kategoria kryesore që kontribuoi në rritjen e shpenzimeve buxhetore gjatë TM3 2020 ishte ajo e subvencioneve dhe transfereve, e cila arriti vlerën prej 197.6 milionë euro apo 34.9 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Me rritje prej 7.5 përqind u karakterizuan edhe shpenzimet për paga, të cilat arritën nivelin prej 164.0 milionë euro. Kategoritë tjera të shpenzimeve buxhetore shënuan rënie. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe shpenzimet komunale) shënuan rënie prej 2.2 përqind dhe arritën vlerën 68.0 milionë euro, përderisa shpenzimet kapitale shënuan rënie për 5.8 përqind dhe arritën vlerën 111.8 milionë euro.

Borxhi publik në TM3 2020 ka arritur në 1.3 miliardë euro, që është për 12.2 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2019. Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 19.9 përqind nga 17.4 përqind sa ishte në TM3 2019. Rritja e borxhit publik i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 18.7 përqind (që ka arritur në 934.5 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie për 0.3 përqind dhe ishte 407.3 milionë euro. Pjesëmarrja e borxhit të jashtëm publik në gjithsej borxhin publik është zvogëluar në 30.4 përqind, nga 34.2 përqind sa ishte në TM3 2019. Pragu i borxhit publik i paraparë me ligj në Kosovë është 40 përqind e BPV-së, rrjedhimisht niveli i borxhit publik

prej 19.9 përqind e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit. Sidoqoftë, ky nivel i ulët i borxhit publik mund të rritet shpejt në të ardhmen si rezultat ndikimeve negative të pandemisë COVID-19 në ekonominë e Kosovës dhe planeve të qeverisë për ta financuar deficitin buxhetor nëpërmjet borxhit publik.

Sektori Financiar⁴

Në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u zgjeruan për 258.8 milionë euro në TM3 2020, duke reflektuar kryesisht rritjen e aktivitetit të sektorit bankar dhe atij pensional. Rritja e aseteve të sektorit bankar kryesisht i'u atribua rritjes së burimeve të financimit të sektorit (kryesisht depozitave të arkëtuara), që u reflektuan në rritje të aktivitetit kreditor. Kurse, rritja e aseteve të sektorit pensional u mbështet nga rritja e kontributeve të arkëtuara dhe kthimit nga investimet gjatë kësaj periudhe. Krahasuar me TM3 2019, aktiviteti kreditues shënoi rritje, e që ishte më i theksuar për ekonomitë familjare kundrejt rritjes së kreditimit për korporatat jofinanciare gjatë TM3 2020. Kreditë e reja gjatë këtij tremujori shënuan rritje të theksuar vjetore për të dy kategoritë: ekonomitë familjare dhe ndërmarrjet. Sektori bankar shënoi fitim neto në vlerë prej 17.6 milionë euro në këtë tremujor, që është më i ulët për 7.7 milionë euro krahasuar me TM3 2019. Zvogëlimi i shënuar në fitimin e sektorit kryesisht i atribuohet rritjes më të lartë të shpenzimeve kundrejt rritjes më të ngadalësuar të të hyrave të sektorit. Treguesit e shëndetit financiar të sektorit vazhdojnë të jenë në vlera të kënaqshme. Sektori bankar vazhdon të

⁴ Për më shumë informata rreth zhvillimeve në sektorin financiar referojuni publikimit: Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiarë (TM3 2020) i publikuar në faqen e internetit të BQK-së.

karakterizohet me cilësi të lartë të portfolios kreditore, edhe pse ka ndërruar kahje, dhe me mbulueshmëri optimale me provizione. Indikatorët e solvencës dhe likuiditetit vazhdojnë të jenë mbi nivelin minimal të rekomanduar me rregullore (prej 12.0 përqind përkatësisht 25.0 përqind).

Spektori pensional u karakterizua me zgjerim të aktivitetit edhe gjatë TM3 2020, si rrjedhojë e kontributeve të arkëtuara dhe kthimit pozitiv nga investimet në dy tremujorët e fundit. Edhe sektori i sigurimeve gjatë TM3 2020 u karakterizua me rritje të aktivitetit, edhe pse në nivel më të ulët krahasuar me TM3 2019. Vlera e primeve të arkëtuara shënoi rritje të lehtë gjatë kësaj periudhe. Kurse, vlera e dëmeve të paguara dhe atyre të ndodhura ishte dukshëm më e lartë krahasuar me periudhën paraprake.

Gjatë TM3 2020, sektori mikrofinanciar ka shënuar ngadalësim të theksuar të rritjes së aktivitetit dhe performancë financiare më të ulët kundrejt vitit paraprak. Megjithatë, sektori vazhdon të ketë cilësi të mirë të portfolios kreditore,.


Gjatë TM3 2020, Qeveria e Kosovës emetoi borxh në vlerë dukshëm më të ulët kundrejt tremujorit paraprak (TM2 2020) dhe TM3 2019. Kjo rënie e nivelit të borxhit sovran të emetuar reflekton nevojat e Qeverisë së Kosovës për të financuar aktivitetin e saj përmes këtij instrumenti.

Spektori i Jashtëm

Deri në shtator 2020, deficitin e llogarisë rrjedhëse ishte 308.1 milionë euro, që është për 129.7 përqind më i

lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Viteve të fundit bilanci i llogarisë rrjedhëse ka qenë pozitiv gjatë tremujorit të tretë, ndërsa gjatë TM3 2020, është shënuar deficit prej 90.9 milionë euro (151.9 milionë euro suficit në TM3 2019). Rritja e deficitit të llogarisë rrjedhëse në TM3 2020 i atribuohet kryesisht zvogëlimin të bilancit pozitiv të shërbimeve. Në anën tjetër, deficitin e mallrave ishte më i ulët si dhe bilancet pozitive të të ardhurave parësore dhe të ardhurave dytësore rezultuan më të larta (figura 4).

Figura 4. Deficitin e llogarisë rrjedhëse dhe komponentët e saj, në milionë euro




Burimi: BQK (2020)

Deficitin në llogarinë e mallrave⁵ arriti vlerën prej 2.0 miliardë euro deri në shtator 2020, që paraqet një rënie vjetore prej 12.1 përqind (3.0 përqind rritje në periudhën e njëjtë 2019). Vetëm në TM3 2020, deficitin tregtar të mallrave ishte 738.3 milionë euro apo 11.4 përqind më i ulët krahasuar me TM3 2019. Kjo rënie e deficitit të mallrave i atribuohet kryesisht rritjes së eksportit dhe rënies së importit të mallrave.

Vlera e eksportit të mallrave në TM3 2020 ishte 118.7 milionë euro, një rritje vjetore prej 7.1 përqind (figura 5).

⁵ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave është Agjencia e Statistikave të Kosovës.


Figura 5. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro



Burimi: ASK (2020)

Rritja e eksportit të mallrave gjatë TM3 2020 ishte më e theksuar tek perimet, tekstili dhe artikujt e tekstilit, produktet e plastikës dhe gomës, etj. Në anën tjetër, rënie shënoi eksporti i metaleve bazë, produkteve minerale, etj. (figura 6).

Figura 6. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2020)

Vlera e importit të mallrave ishte 857.0 milionë euro në TM3 2020, që paraqet rënie vjetore prej 9.3 përqind. Në rënien e importit ka ndikuar kryesisht niveli më i ulët i importit të produkteve minerale (kryesisht derivate të naftës), kategori e cila ka shënuar rënie të çmimeve në tregjet ndërkombëtare. Me rënie të theksuar është karakterizuar edhe importi i ushqimeve të përgatitura, pijeve dhe duhanit, importi

i tekstilit dhe artikujve të tekstilit si dhe importi i perimeve. Në anën tjetër, importi i makinerive dhe pajisjeve elektrike, importi i mjeteve të transportit, metaleve bazë, si dhe importi i produkteve të plastikës dhe gomës shënoi rritje (figura 7).

Figura 7. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2020)

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 147.7 milionë euro në TM3 2020, rënie vjetore prej 72.8 përqind. Vlera e shërbimeve të eksportuara ishte vetëm 334.9 milionë euro apo 59.4 përqind më pak krahasuar me TM3 2019. Duke pasur parasysh faktin se rreth gjysma e eksportit të shërbimeve të udhëtimit realizohet në TM3 si dhe masave kufizuese që ndërmonen qeveritë e vendeve ku janë të koncentruar diaspora kosovare, atëherë është e kuptueshme kjo rënie e eksportit të shërbimeve. Rënia e eksportit të shërbimeve rezulton të jetë njëri prej kanaleve të jashtme kryesore të transmetimit të krizës. Në anën tjetër, vlera e shërbimeve të importuara ishte 187.2 milionë euro apo 33.9 përqind më pak krahasuar me TM3 2019. Sikurse tek eksporti i shërbimeve edhe tek importi, rënia më e lartë është shënuar tek shërbimet e udhëtimit dhe shërbimet e transportit, që ndërliken me masat kufizuese të ndërmarrja për parandalimin e përhapjes së virusit korona.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore shënoi vlerën prej 41.3 milionë euro, që paraqet rritje prej 75.5 përqind. Në anën tjetër, bilanci i të ardhurave dytësore arriti në 395.5 milionë euro, që është për 14.2 përqind më i lartë krahasuar me TM3 2019. Remitencat e pranuar në Kosovë shënuan vlerën prej 697.0 milionë euro deri në shtator 2020, që paraqet rritje për 11.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë 2019. Vetëm në TM3 2020 vlera e remitencave të pranuar ishte 262.2 milionë euro, apo 18.1 përqind më shumë krahasuar me TM3 2019 (figura 8).

Figura 8. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2020)


Remitencat që pranohen në Kosovë vazhdojnë të vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra, prej nga u dërguan 43.1 përqind përkatësisht 24.3 përqind e gjithsej remitencave në TM2 2020. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 5.4 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Përkundër faktit se edhe vendet ku janë të koncentruar diaspora kosovare janë goditur shumë nga kriza e pandemisë, remitencat kanë shënuar përsheptim të rritjes. Rritja e remitencave ka qenë dyshifrore gjatë gjithë periudhës, me përjashtim të muajit mars dhe prill kur shënuan rënie. Dërgesat e

remitencave përmes operatorëve që transferojnë para kanë shënuar rritje për 62.0 përqind deri në shtator ndërsa remitencat që dërgohen përmes bankave kanë shënuar rritje për 10.3 përqind. Në anën tjetër, duke pasur parasysh mbylljen e kufirit si dhe kufizimeve të tjera, remitencat që vijnë përmes “kanalit jo-formal” kanë shënuar rënie prej 57.5 përqind deri në shtator 2020. Ky trend i rritjes së remitencave pritet të vazhdoj edhe në muajt vijues (vetëm në muajin tetor rritja e remitencave ishte 27.6 përqind).

Llogaria financiare e bilancit të pagesave shënoi vlerën prej -293.0 milionë euro (-36.5 milionë euro deri në shtator 2019). Vetëm gjatë TM3 2020 bilanci i llogarisë financiare ishte -0.4 milionë euro (108.6 milionë euro në TM3 2019). Detyrimet në kuadër të llogarisë financiare shënuan rritje prej 9.3 përqind gjatë TM3 2020. Në kuadër të llogarisë financiare, IHD-të në Kosovë arritën vlerën prej 250.6 milionë euro deri në shtator 2020, që janë për 15.8 përqind më të larta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2019. Rritje e niveli të IHD-ve është shënuar në TM1 dhe TM2 ndërsa në TM3 2020 është shënuar nivel më i ulët i IHD-ve prej 27.0 përqind krahasuar me TM3 2019.

Nga 77.1 milionë euro, sa ishte niveli i IHD-ve në TM3 2020, 70.2 milionë euro ishin në formë të kapitalit dhe fondit të investimeve në aksione, ndërsa 6.9 milionë euro në formë të instrumenteve të borxhit (figura 9).

Figura 9. Struktura e investimeve të huaja direkte,
në milionë euro



Burimi: BQK (2020)

Rritja e IHD-ve në TM3 2020 u evidentua tek sektori i shërbimeve financiare, sektori i ndërtimtarisë dhe ai i tregtisë, ndërsa sektorët tjerë shënuan rënie. Vetëm në sektorin e patundshmërive niveli i IHD-ve ishte 52.4 milionë euro, apo 32.9 përqind më pak krahasuar me TM3 2020. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Gjermania paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në TM3 2020 (24.9 milionë euro), pasuar nga Zvicra (16.6 milionë euro), SHBA (9.4 milionë euro), Turqia (8.6 milionë euro), etj.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2020): Vlerësimi Tremujor i Zhvillimeve Makroekonomike nr. 32, TM3 2020, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Referencat:

BQK (2020):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <https://bqk-kos.org/?id=55>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <https://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2020):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: <https://ask.rks-gov.net/media/5373/hck-mars-2020-shqip.pdf>
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: <https://ask.rks-gov.net/media/5438/indeksi-i-çmimeve-te-prodhimit-tm1-2020-shqip.pdf>
- c) Indeksi i çmimeve të importit: <https://ask.rks-gov.net/media/5432/indeksi-i-çmimeve-të-importit-içimp-tm1-2020.pdf>
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <https://ask.rks-gov.net/media/5391/rep-stat-mbi-ndër-ekono-në-kosovë-tm1-2019.pdf>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <https://ask.rks-gov.net/media/5382/statistikat-e-tregtisë-së-jashtme-stj-mars-2020.pdf>

IMF (2020): World Economic Outlook: <https://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2020/01/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	Shtator 2019	Shtator 2020
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)*	3,245.3	3,073.9
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	3.0%	0.3%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	2.4%	-0.5%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	1,379.3	1,215.2
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	1,340.3	1,413.1
Bilanci primar (në milionë euro)	39.1	-197.9
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	7,006.3	7,671.0
prej të cilave: Bankat	4,577.2	5,036.0
Kredi	2,957.2	3,182.5
Depozita	3,735.6	4,055.4
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.54%	6.35%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.50%	1.49%
Hendeku i normës së interesit	5.0%	4.9%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-144.2	-301.8
prej të cilave: remitencat e pranuar	627.6	697.0
Llogaria financiare	-36.5	-293.0
Investimet e huaj direkte në Kosovë	216.4	250.6
Investimet portfolio, net	-23.6	-35.6
Investimet tjera, net	-143.3	-62.1
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-462.4	-709.7
Asetet	4,912.3	5,076.3
Detyrimet	5,374.7	5,786.1
Borxhi i jashtëm, gjithsej*	2,155.0	2,273.0
Borxhi i jashtëm privat	1,663.2	1,754.4
Borxhi i jashtëm publik	491.7	518.6

Burimi:

1/ ASK (2020).

2/ MF (2020).

3/ BQK (2020).

*Të dhënat për BPV, PNI dhe borxh të jashtëm deri në qershor 2020.

